

# Raporti i nëntë tremujor

korrik-shtator 2013.



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



 UNOPS

Sprovodi program

**euprogres** 

Program evropskog partnerstva sa opštinama

## Përmbledhje

Gjatë verës nuk ka pasur ndërprerje në implementimin e Programit- implementimi ka qenë efikas kurse numri i projekteve në të cilët është shënuar vonesë është përmirësuar (nga 34 në 17) përdërisa vetëm një projekt ka qenë në fazë kritike. Nga 239 projekte të kontraktuara, 166 (69%) kanë përfunduar, që paraqet rritje prej 7% në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2013; implementimi i 44 (18%) të projekteve është zhvilluar në tërësi sipas planit kurse implementimi i një projekti është ndaluar. Deri më tani gjithsejt janë ndërprerë 11 projekte. Deri në fund të shtatorit 2013 gjithsejt janë ndarë 13.457.419,10 euro, mjete të Programit, respektivisht 80,9% e buxhetit.

Pas një viti kriza ekonomike është bërë sfida më e madhe e Programit, përveç politikës. Qeveria në fillim të korrikut ka bërë revizionin e buxhetit dhe ka zvogëluar mjetet për ministritë dhe vetqeverisjet lokale, përdërisa ndërmarrjet kanë gjithnjë më shumë vështirësi që të mbajnë likuiditetin. EU PROGRES-i më aplikimin e metodologjisë së ndihmës së pakthyeshme ka zbutur rreziqet prandaj zbatimi i Programit ka vazhduar me vonesa minimale. Por, ndikimi i mundshëm i krizës ekonomike në efektin e përgjithshëm të Programit, si dhe në projekte të tjera dhe intervenime zhvillimore, jep arsye për brengë.

Lajm i mirë është se në periudhën raportuese janë punësuar 112 persona – përmes dy projekteve lidhur me çerdhet, biznes inkubacionin virtual të ndërmarrësve romë, projekte të financuara me anë të Fondit për pjesëmarrje qytetare dhe duke iu falënderuar zbatimit të planeve lokale të akcionit të hartuara me anë të përkrahjes së EUPROGRES-it.

Gjithashtu vlen të theksohen disa projekte ekologjike të cilat janë implementuar: projektet për deponi Regjionale Banjica dhe Meteris dhe Studimi i zbatueshmërisë për Parkun Nacional Kopaonik krijojnë bazë për intervenime në shumë prej 17,5 miliona euro. Banjica është shembull posaçërisht i mirë i bashkëpunimit ndërkomunal dhe gjithashtu mund të konsiderohet edhe si tregues i stabilitetit të avancuar në atë rajon.

Kur flasim për projektet e vogla infrastrukturore, projektet e zbatuara lidhur me avancimin e arsimimit kanë arritur potencialin e vet të plotë gjatë këtij tremujori. Për shembull, më nuk ekziston lista e pritjes për regjistrimin e fëmijëve në çerdhen e Rashkës. Janë zbatuar edhe pesë projekte të vogla: dy duke iu falënderuar të cilëve 3.500 qytetar janë furnizuar me ujë, dy lidhur me tregjet dhe një lidhur me nxemjen e sallës së sportit në Novi Pazar. Projektet lidhur me avancimin e qasjes së mbrojtjes shëndetësore do të përfundojnë gjatë tremujorit të ardhshëm në jug dhe jugperëndim të Serbisë.

Duke iu falënderuar nënshkrimit të aneksit të marrëveshjes me Agjencionin Zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim në vlerë prej 402.850 euro, Programi ka mundësi të vazhdojë të përkrah mekanizmat lokal për barazinë gjinore, ndan ndihmë të pakthyeshme për forcimin e grave dhe vazhdon të stimulojë pjesëmarrjen e femrave në vendimmarrje në lokal.

Studimi paraqet një element të rëndësishëm të përcjelljes dhe vlerësimit të rezultateve të EUPROGRES-it, si dhe planifikimi i programeve të ardhshme zhvillimore dhe intervenimeve. Momentalisht janë duke u implementuar dy studime: lidhur me konkurrencën e komunave

dhe përmbushjen e kërkesave të qytetarëve. Të dyja hulumtimet duhet të përfundojnë deri në fund të vitit dhe të dyja duhet të zbatohen në nëntë komunat shtesë të cilat duhet të marrin pjesë në Program i cili do të vijojë pas EUPROGRES-it.

Komunikimi me publikun mund të kualifikohet si intenziv- janë publikuar më pak se 300 raporte në media kurse faqja e internetit e EUPROGRES-it ka shënuar gati 5.000 vizita individuale për periudhën raportuese. Brendimi i projekteve fillon të japë rezultate. Për shembull, 20 gazetar të mediave me mbulesë nacionale kanë vizituar Novi Pazarin dhe kanë publikuar disa nga raportet më pozitive lidhur me këtë Qytet gjatë viteve të fundit.

Tremujori i fundit i vitit 2013 do të jetë intenziv. Programi shpreson të ketë kushte të mira klimatike, me çka do të zvogëlohet rreziku nga vonesat në implementimin e disa projekteve. Një nga detyrat kryesore do të përfshijë përcjelljen e financave të Programit. Këshilli drejtues i Programit do të jetë i njoftuar në kontinuitet për këto sepse ndoshta do të duhet të merren vendime të shpejta të cilat do të mundësojnë shpenzimin e të gjitha mjeteve deri në përfundim të Programit, në mars të vitit 2014.